



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Date 15.06.2021

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia Tiranë
Adresa	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
Tel/Fax	0035542256799
E-mail	administrative.prokurime@tirana.al
Adresa e Internetit	www.tirana.al

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 1(një) biletë udhëtimi vajtje ardhje Tiranë -Salzburg”**.

Data e zhvillimit do të jetë **15.06.2020 ora 17.35** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit), si më poshtë:

“Blerje 1(një) biletë udhëtimi vajtje ardhje Tiranë -Salzburg”.

sipas itinerarit:

- Itinerari: Tiranë -Salzburg -Tiranë
- Nisja nga Tirana drejt Salzburgut do të bëhet në datën 17.06.2021 herët në mëngjes, mbërritja para orës 11.00.
- Kthimi nga Salzburg në Vienë do të bëhet në datën 19.06.2021 në drekë pas orës 16.00.
- Kthimi nga Viena drejt Tiranës do të bëhet në datën 20.06.2021 në drekë.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, **Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar**.

Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për realizimin /mosrealizimin e objektit të prokurimit, brenda 2 orëve nga momenti i njoftimit në sistem, në të kundërt operatori do të s'kualifikohet duke përzgjedhur ofertuesin ekonomik i renditur i dyti në listën e ofertave që kanë mbetur, deri në ofertuesin e renditur në vend të fundit.

Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë menjëherë (elektronikisht) duke filluar nga momenti i shpalljes së fituesit.

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.